




Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

**PERCEPTIMET
E OPINIONIT
PUBLIK
SHQIPTAR
NDAJ**



**SIGURISË
PERSONALE,
KOMBËTARE
E RAJONALE**

TETOR 2013

Përmbledhje Ekzekutive

Sondazhi, disa prej gjetjeve kryesore të të cilit, së bashku me interpretimin përkatës, paraqiten më poshtë, u zhvillua gjatë muajit Tetori 2013. Ai ishte pjesë e iniciativës të “Forumit Kërkimor për Sigurinë”¹ për të kryer sondazh të njëkohshëm në Shqipëri, Serbi e Kosovë, me fokus sigurinë (sigurinë personale, kombëtare e rajonale). Të paktën për sa i përket Shqipërisë, pranohet gjerësisht që në të shkuarën, përpjekjet për të vlerësuar perceptimin e publikut në lidhje me sigurinë kanë qenë fare të pakta. Në më të shumtat e rasteve, ato të dhënat kanë rezultuar si “produkte dytësore” të sondazheve të kryera për çështje të tjera madhore, të tilla si anëtarësimi i Shqipërisë në NATO,² etj.

1. Forumi Kërkimor për Sigurinë startoi në Tetor 2012. I mbështetur nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë, ai përfshin Qendrën e Beogradit për Politikë e Sigurisë (BCSP) Qendrën Kosovare për Studimet e Sigurisë (KCSS) dhe Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) Tiranë.

2 Realizuar nga Instituti për Demokraci e Ndërmjetësim në Prill-Maj 2007

Për një menaxhim më të mirë të intervistave dhe interpretim më të lehtë të tyre, pyetjet e këtij sondazhi janë grupuar në katër grupe kryesore: siguria personale, perceptimi i shqiptarëve ndaj institucioneve shtetërore të sigurisë, perceptimi në lidhje me kërcënimet e jashtme dhe së fundi, si opinioni publik shqiptar e percepton bashkëpunimin në fushën e sigurisë midis Shqipërisë, Kosovës dhe Serbisë.

Bazuar në përgjigjet e të intervistuarve, në lidhje me grupin e parë të pyetjeve, siguria personale, konstatohet një qasje individualiste. Një pjesë e rëndësishme e të intervistuarve preferojnë të mbështeten në mjetet e veta, për të garantuar sigurinë e vet apo të familjarëve të tyre. Familja dhe të afërmit/miqtë mbeten në qendër të interesit dhe besimit për Shqiptarët.

Në lidhje me grupin e dytë të pyetjeve, perceptimi për institucionet e sigurisë, përveç një nivel relativisht të ulët besimi, i shprehur nga të intervistuarit në

mënyrë direkte, nëpërmjet përgjigjeve të tyre ose indirekt, nëpërmjet një grupi të madh që refuzuan të përgjigjeshin, sërish rezultojnë një përqindje e lartë e atyre që preferojnë të merren me kërcënimet vetë, në vend që të kërkojnë mbrojtje prej institucioneve të sigurisë.

Për sa i përket grupit të tretë të pyetjeve, kërcënimet e jashtme, perceptimi i shqiptarëve duket objektiv. Në përgjithësi, ata e konsiderojnë mundësinë e një kërcënimi të jashtëm konvencional ndaj Shqipërisë si “tepër të ulët”, ndërsa në lidhje me vendet fqinje, mundësia e një kërcënimi të tillë, e ardhur prej tyre, konsiderohet në rangun e rreth 3%. Në përgjithësi, bazuar në përgjigjet e të intervistuarve, mënyra më e mirë për mbrojtjen e integritetit kombëtar, konsiderohet nëpërmjet anëtarësimit dhe pjesëmarrjes në organizata të mëdha ndërkombëtare (konkretisht NATO dhe BE).

Së fundi, në lidhje me bashkëpunimin me Kosovën dhe Serbinë me qëllim fuqizimin e përbashkët të sigurisë, per-

ceptimi i shqiptarëve është tepër pozitiv. Për më tepër, shkëmbimet ekonomike e tregtare, konsiderohen si mjete shumë efektive për ndërtimin e besimit dhe forcimin e sigurisë midis këtyre vendeve, diçka më të vlerësuar se bashkëpunimi midis institucioneve të sigurisë, ndërsa disa forma të tjera disi më “elitare” si aplikimi i përfaqësimeve të përbashkëta në evente ndërkombëtare, është klasifikuar në fund të shkallës së vlerësimit.

Bazuar në përgjigjet e të intervistuarve dhe shkallën e konsistencës prej një grupi pyetjesh tek tjetri, gjë që kontraston me rezultatet e disa sondazheve të së shkuarës, mund të konstatohet një qëndrim i ri i qytetarëve shqiptarë ndaj këtyre formave të matjes së opinionit publik. Krahas progresit të proceseve demokratike në Shqipëri, qytetari shqiptar po ndjen se opinioni i tij vlen, gjë që e bën atë më të motivuar në shprehjen e pikëpamjeve të tij ndaj çështjeve të ndryshme me rëndësi të madhe për shoqërinë.

Metodologjia

Procesi i përgatitjes së metodologjisë dhe pyetësorit për këtë sondazh u udhëhoq nga ekipi i KCSS, ndërsa partnerët e tjerë gjithashtu kontribuan ndjeshëm në finalizimin e tij sikurse edhe në përshtatjen dhe adoptimin e produktit final në përshtatje me kushtet dhe kontekstin specifik të secilit vend.

Në Shqipëri, studimi u krye nga një grup studiuesish i përbërë nga 2 studiues në qendër dhe 18 studiues të terrenit. Sondazhi mbi bazë kombëtare u zgjedh si më i përshtatshmi për të realizuar objektivat e projektit studimor. Ai i krye gjatë muajit Tetor 2013 në të 36 rrethet e vendit. Sondazhi u krye mbi bazën e një pyetësori me 79 pyetje³ Masa kryesore e pyetjeve ishte “pyetje të mbyllura” (me

vetëm 4% “pyetje të hapura”). Sondazhi u realizua nëpërmjet intervistave “sy më sy”, ndërsa të anketuarit ishin zgjedhur në mënyrë rastësore.


Në total, kampioni kombëtar ishte 1100 të anketuar, të zgjedhur për të përfaqësuar popullsinë shqiptare të moshës mbi 18 vjeç, bazuar në grupimin gjeografik dhe qytetar/urban të publikuar në Raportin e Censurit Shqiptar 2011. Zgjedhja rastësore e kampionit, siguroi mundësi të barabarta për çdo banor shqiptar të moshës mbi 18 vjeç, për t’u përfshirë në kampion duke fuqizuar vlerën e jashtme të studimit dhe mundësuar kryerjen e përgjithësimeve për të gjithë popullsinë e targetuar. Kampioni final i të anketuarve përfshinte 52% meshkuj dhe 48% femra të shpërndarë në mënyrë të barabartë midis zonave urbane dhe rurale.

3. Disa prej pyetjeve të këtij sondazhi ishin detajuar më tej me nënpyetje të cilat në total arrinin në mbi 120 pyetje.

I. Perceptimi i publikut shqiptar për sigurinë personale

Grupi i parë i pyetjeve u përqendrua tek **siguria personale**. Brenda këtij grupi, sondazhi vlerësoi perceptimet e publiku mbi sigurinë individuale dhe atë në nivel lokal. Nga kjo doli në pah se me zgjerimin gradual të zonës së vlerësuar, nga banesat individuale drejt lagjeve, fshatrave/qyteteve dhe më pas, në nivel kombëtar, ka një reduktim gradual të nivelit të perceptuar të sigurisë (Fig.1). Kështu, ndërsa 65% e të intervistuarve ndihen kryesisht ose tërësisht të sigurt në shtëpitë e tyre (kundrejt 13% që ndihen kryesisht/tërësisht të pasigurt), këto shifra ndryshojnë në favor të atyre që ndihen “të pasigurt”, respektivisht me 54% kundrejt 16% në nivel fshati/qyteti dhe 33% kundrejt 28% në nivel kombëtar. Në këtë kontekst, është interesante të vërehet se nuk ka ndonjë ndryshim të dukshëm ndërmjet nivelit të sigurisë në shtëpi dhe atij në lagje, çka tregon se pavarësisht zgjerimit të madh urban dhe dinamikës të përzierjes së popullatës që kanë shoqëruar zhvillimet socio-politike të dy dekadave të fundit, ende komunitetet në lagje mbeten deri diku të besueshëm përsa i përket sigurisë individuale.


Figura 1: Siguria personale



Në këtë sondazh i ishte dhënë një rëndësi e veçantë shkaqeve të perceptimit të sigurisë (Fig.2). Kësisoj gjatë përgjigjeve ndaj pyetjes lidhur me “arsyet për sigurinë”: 50% e të anketuarve

e lidhin sigurinë me bindjen e tyre ndaj ligjit dhe rendit, ndërkohë që 26% e tyre e kushtëzojnë sigurinë me faktin se jetojnë në një lagje të qetë. Është gjithashtu interesante të shihet se 18% e të intervistuarve mbështeten tek aftësia për t'u vetë-mbrojtur. Kjo përqindje relativisht e lartë e njerëzve të cilët “ia besojnë vetes” garantimin e sigurisë personale, nxjerr në pah nivelin e ulët të besimit që publiku ka tek institucionet shtetërore të sigurisë dhe një qasje “të qendëruar tek individit” e cila shpesh ka shkaktuar një dobësim të dukshëm të lidhjeve me komunitetin. Një tjetër gjetje interesante është fakti se vetëm 4% e të intervistuarve mendojnë se policia “po bën punën e saj mirë”. Pavarësisht vështirësive për të konkluduar lidhur me dinamikën e ndryshimit në kohë të këtij perceptimi, rrjedhjet e mungesës së pyetësorëve të kësaj natyre në të shkuarën, në vetvete kjo shifër flet për një nivel të ulët besimi që publiku ka kundrejt rolit të shtetit si ofrues i sigurisë në përgjithësi.


Figura 2: Nëse ndiheni i sigurt, cili është shkaku kryesor për këtë?



E lidhur drejtpërdrejt me arsyet për perceptimet e publikut mbi nivelin e sigurisë, identifikimi i rreziqeve ndaj sigurisë fizike prej publikut shqiptar paraqet gjithashtu një pamje interesante (Fig.3) Aksidentet rrugore janë në krye të listës dhe përmenden nga 32% e të intervistuarve. Kjo është e pritshme duke pasur parasysh nivelin e lartë të aksidenteve rrugore të cilët janë rritur dukshëm gjatë dy vjetëve të fundit. Në nivel të afërt me këtë rrezik për sigurinë, publiku shqiptar konsideron “zënkat/incidentet e dhunshëm” dhe “vjedhjet”. Secili prej

tyre përmendet respektivisht nga 26% e të anketuarve. Këto rezultate nxjerrin në pah shqetësimin e gjerë të publikut, i cili shprehet edhe nga shumë aktorë të tjerë të fushës si shoqëria civile, media etj, që mbështetet gjithashtu prej statistikave zyrtare lidhur me një rritje të frikshme të përmasave të secilit prej këtyre fenomeneve. Nga ana tjetër “dhuna në familje” e cila përmendet prej 12% e të intervistuarve konsiderohet një tjetër shqetësim për sigurinë, i cili reflekton trendin e ri të një farë dobësimi, deri në prishje të lidhjeve familjare. Në kundërshtim me to, “incidentet ndëretnike” konsiderohen si shqetësim vetëm prej 1% e të intervistuarve duke dhënë mesazhe për nivelin e tolerancës në shoqërinë shqiptare si dhe perceptimin (që mbështeten edhe nga të dhënat e fundit të censusit) të një niveli relativisht të lartë homogjeniteti etnik në popullsinë shqiptare.


Figura 3: Cila prej rrethanave të mëposhtëme përbën shqetësimin më të madh për sigurinë në komunitetin ose fshatin/qytetin tuaj?



II. Perceptimi i publikut shqiptar në lidhje me institucionet e sigurisë

Grupi i dytë i pyetjeve u përqendrua tek **institucionet e sigurisë**. Në mënyrë befasuese vërehet se gjatë përgjigjes së pyetjes “Cili institucion sigurie kontribuon më shumë tek perceptimet tuaja për sigurinë”, 60% e të intervistuarve refuzon të japë një përgjigje (Fig.4). Nevojitet studim i mëtejshëm për të përcaktuar nëse kjo vjen nga një ndjesi mohimi apo nga mungesa e njohurive ndaj këtyre institucioneve. Pavarësisht kësaj, ky pohim përbën një tregues për faktin se shumë institucione shtetërore të sigurisë kanë shfaqur “një profil të ulët” gjatë ushtrimit të rolit të tyre për të ofruar siguri publike. Kështu, qeveria qendrore, organet e pushtetit vendor dhe institucionet e drejtësisë konsiderohen si kontribues për sigurinë nga 1% e të anketuarve (për secilën prej tyre). 37% e të intervistuarve konsiderojnë policinë si ofrues kryesor të sigurisë, gjë që ishte e pritshme, për shkak të misionit të drejtpërdrejtë që ajo ka në këtë drejtim. Pavarësisht kësaj, duhet sjellë ndërmend se në pyetjen e mëparshme, vetëm 4% e të anketuarve besojnë se “policia po e kryen mirë misionin e vet”.


Figura 4: Cili institucion sigurie ndikon më shumë në sigurinë tuaj?



Ekziston një lidhje e qartë ndërmjet të dhënave që dalin nga pyetja “Ku bazoheni më shumë për të garantuar sigurinë tuaj dhe të familjes tuaj?” dhe pyetjes së përmendur më sipër lidhur me “arsyet kryesore për t’u ndier i sigurt” (Fig.5).


Në të dy raste qasjet “egocentrike” dhe “të orientuara tek vetja” janë të dukshme. Kështu, 51% e të intervistuarve bazohen tek vetja e tyre për mbrojtjen e sigurisë së familjeve të tyre. Nëse kësaj shifre do t’i shtonim edhe ata (10%) që bazohen tek shokët e tyre dhe të tjerët (7%) që bazohen tek fqinjët, rezulton se mbi 2/3 (ose 68%) e popullsisë nuk i konsiderojnë institucionet shtetërorë të sigurisë si ofrues të vërtetë të sigurisë dhe bazohen tek vetja e tyre dhe tek personat e afërt për sigurinë e tyre dhe të familjes së tyre. Një tjetër gjetje interesante që lidhet me këtë pyetje është se ndërsa, siç u përmend edhe në pyetjen e mëparshme, 37% e të anketuarve e konsiderojnë policinë si kontribuesin kryesor për një perceptim të përgjithshëm të sigurisë, aktualisht vetëm 23% besojnë se policia mund të garantojë sigurinë e tyre ose atë të familjes së tyre. Në këtë kontekst, ushtria apo aktorë të tjerë shtetërorë apo privatë, konsiderohet se kanë rol për sigurinë vetëm nga 1% e të anketuarve ndërkohë që 3% e tyre nuk i besojnë askujt. Kjo nxjerr në pah nevojën për më tepër studim lidhur me rolin dhe kontributin e këtyre institucioneve në kontekstin e sigurisë personale.

Figura 5: Ku mbështeteni më shumë për sigurinë tuaj dhe të familjes suaj?



Pavarësisht perceptimeve të sipërpërmendura kur analizohet pyetja se “ku do ta raportonit një krim apo incident të dhunshëm”, 81% e të intervistuarve shprehen se do të raportonin në polici (Fig.6). Megjithëse në pamje të parë kjo duket pozitive, ky tregues gjithashtu le vend për diskutim kur projektohet në krahasim me 9% të të anketuarve të cilët do të raportonin tek anëtarët e familjes dhe shokët dhe me 5% të të intervistuarve që nuk do t’i tregonin askujt. Së bashku, rezulton që 14% e të intervistuarve nuk do ta raportonin një akt krimi apo dhune ku ata mund të ishin viktimë apo dëshmitarë, një numër ky relativisht i lartë. Ky fakt ka nevojë për studime dhe thellime të mëtejshëm duke pasur parasysh edhe nivelin e ulët të besimit kundrejt institucioneve të sigurisë (e sidomos policisë) dhe nivelin relativisht të lartë të vetëgjyqësive dhe hakmarrjeve që ende dominojnë reagimet e shumë shqiptarëve kundrejt një akti dhune apo sjelljeje abuzive që iu adresohet atyre dhe familjeve të tyre. Në kontrast me këtë, vetëm 1% e të intervistuarve mendojnë se udhëheqësit politikë vendorë janë institucioni i duhur për raportimin e këtyre akteve të dhunës.

Figura 6: Ku do ta raportonit ju një krim apo incident dhune?




Një tjetër pyetje synonte të maste perceptimet e publikut mbi nivelin e kompetencave të disa prej institucioneve (konkretisht të policisë, forcave të armatosura, shërbimit informativ, emergjencave civile dhe drejtësisë) për misionin e tyre për mbrojtjen e sigurisë kombëtare të Shqipërisë (Fig.7).

Nga kjo perspektivë, përqindja e të

anketuarve të cilët konsideronin institucionet e sigurisë në Shqipëri si “të aftë” është relativisht e vogël: për Forcat e Armatosura në nivelin 37% dhe thuhet 20% respektivisht për policinë dhe shërbimin informativ, ndërkohë që për emergjencat civile dhe institucionet e drejtësisë shifra zbrit në respektivisht 12% dhe 10%. Një shpërndarje opinioni thuhet simetrike ndërmjet të anketuarve vërehet ndërmjet atyre që i konsiderojnë këto institucione “të pa afta”. Kështu, ndërsa 45% e të anketuarve konsiderojnë institucionet e drejtësisë si “të pa afta” niveli i paaftësisë përse i përket perceptimit të publikut për emergjencat civile zbrit në 29%. Perceptimi i “paaftësisë” është 17% përse i përket shërbimit informativ dhe disi më mirë për forcat e armatosura (13%). Disa konkluzione mund të nxirren lidhur me kategorinë e të intervistuarve të cilët nuk dinë se si të përgjigjen. Mungesa e njohurive duket të jetë e lartë, 27% lidhur me shërbimin informativ, shifër e cila tregon gjithashtu një nivel pjesërisht të pa justifikuar mbylljeje prej këtij institucioni. Emergjencat civile dhe forcat e armatosura janë më pak të panjohura, por megjithatë, ende kjo shifër është në nivele të larta (përkatësisht 17% dhe 14%) ndërkohë që për institucionet e drejtësisë “mosnjohja” arrin në 9% ndërsa për policinë në 3%, një rezultat disi i pritshëm, kur mbahet parasysh që këto institucione janë më të ekspozuara kundrejt publikut dhe tërheqin një vëmendje më të madhe në lidhje me veprimtarinë që kryejnë.


Figura 7: Kompetenca e institucioneve të sigurisë



III. Perceptimi i publikut shqiptar në lidhje me kërcënimet e jashtme

Grupi i tretë i pyetjeve u përqendrua tek rreziqet e jashtme ndaj sigurisë kombëtare. Bazuar në gjetjet e këtij pyetësi, perceptimet e publikut shqiptar lidhur me nivelin e rrezikut kundrejt sigurisë kombëtare të Shqipërisë rezultoi i arsyeshëm dhe thuhet në të njëjtën linjë me prirjet pozitive të sigurisë në rajonin e Ballkanit (Fig.8). Pra, vetëm 11% e të anketuarve konsiderojnë si “të lartë” nivelin e rrezikut. Nga ana tjetër, 56% e tyre nuk perceptojnë asnjë rrezik, ose e konsiderojnë atë si të ulët. 28% e të anketuarve qëndrojnë “në mes” duke besuar se rreziqet mund të ekzistojnë “deri diku”.


Figura 8: INë opinionin tuaj, në ç’masë është e kërcënuar siguria kombëtare e Shqipërisë?



Perceptimet e publikut lidhur me rreziqet e jashtme për sigurinë kombëtare të Shqipërisë u plotësuan më tej nëpërmjet pyetjeve të lidhura me vendet fqinjë (Fig.9). Lidhur me vendet me të cilat Shqipëria ka fqinjësi të drejtpërdrejtë (Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi) vetëm 2-4% e shqiptarëve besojnë se ato mund të përbëjnë rrezik. 93% e shqiptarëve nuk e konsiderojnë Kosovën si rrezik. Mali i Zi dhe Maqedonia nuk përbëjnë rrezik respektivisht për 85%

dhe 76% të intervistuarve. Nga ana tjetër, është interesante se 20% e të anketuarve shqiptarë konsiderojnë Serbinë si rrezik ndaj sigurisë së Shqipërisë, pavarësisht faktit se ajo është e distancuar nga pikëpamja gjeografike dhe nuk ndan kufij me Shqipërinë. Ky perceptim është disi në kontrast jo vetëm me disa transformime të rëndësishme që po ndodhin në Serbi në aspektin politik dhe atë ushtarak, por edhe me disa zhvillime pozitive që vërehen në marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, të cilat arritën kulmin me marrëveshjen e firmosur nga dy kryeministrat përkatës në 19 prill të vitit 2013. Më shumë sesa me nivelin e informacionit, ky trend mund të shpjegohet me vështirësinë dhe kohën e gjatë që merr procesi i harrimit (ca më pak ai i fshirjes përfundimtare) nga memoria e popullsisë shqiptare të mbresave që lidhen me marrëdhëniet ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në të shkuarën, deri atë të afërt.

Figura 9: Kërcënime të pritshme nga fqinjët




Krahas një opinionit relativisht objektiv rreth faktit se rreziqet tradicionale

kundrejt Shqipërisë janë reduktuar, publiku shqiptar duket i mirë-pozicionuar për sa i përket pyetjes mbi “mënyrën më të mirë për të mbrojtur sigurinë kombëtare” (Fig.10).

61% e të anketuarve mendojnë se kjo realizohet më mirë si pjesë e një familjeje më të madhe vendesh dhe mendojnë se siguria mund të mbrohet përmes NATO (33%) ose përmes BE-së (28%) duke shprehur kështu bindjen dominuese se “mbrojtja kolektive” është mjete më e mirë për arritjen e këtij qëllimi. Megjithatë, 13% e të anketuarve janë pro rritjes së aftësive mbrojtëse të Shqipërisë.

Figura 10: Mënyra më e mirë për mbrojtjen e sigurisë kombëtare




Në lidhje me këtë pyetje është interesante fakti se 26% e të anketuarve nuk e shohin opsionin ushtarak si një zgjidhje. Ndërmjet këtij grupi, 11% janë pro rritjes së reputacionit ndërkombëtar dhe qëndrimit diplomatik, ndërkohë që 15% konsiderojnë fuqinë ekonomike si mënyra më e mirë për mbrojtjen e integritetit kombëtar

IV. Perceptimi i publikut shqiptar në lidhje për bashkëpunimin në fushën e sigurisë


Një tjetër grup mjaft i rëndësishëm pyetjesh në sondazhin tonë përqendrohet tek **bashkëpunimi për sigurinë** me Kosovën dhe Serbinë. Lidhur me pyetjen se si publiku shqiptar percepton forcat e armatosura, policinë dhe shërbimin informativ të këtyre dy vendeve, gjetjet gjithashtu paraqiten interesante. Së pari vërehet një kontrast i pritshëm ndërmjet perceptimeve ndaj institucioneve të sigurisë serbe nga njëra anë dhe atyre kosovare nga ana tjetër. Në lidhje me institucionet serbe të sigurisë (Fig.11), bën përshtypje niveli i konsistencës së perceptimeve për secilin prej institucioneve të sigurisë, gjë që tregon se opinion publik shqiptar thuhet nuk bën dallim për institucionet e sigurisë të Serbisë dhe mënyrës së perceptimit të tyre. Kësisoj, vetëm 17% e të anketuarve shqiptarë i konsiderojnë këto institucione si një kërcënim ndërkohë që rreth 49% e të anketuarve i konsiderojnë ato si jo miqësore (kjo shifër është 41% për SHISH). 30%-35% e të anketuarve mbeten neutral ndaj këtyre institucioneve. Nga ana tjetër rreth 3% e të anketuarve i konsiderojnë këto institucione si “mike” ndërkohë që vetëm 1% e tyre i konsiderojnë si “aleate”.

Figura 11: Institucionet serbe të sigurisë



Në këtë kontekst gjetjet e sondazhit tonë lidhur me perceptimet e shqiptarëve kundërshtojnë institucioneve të sigurisë së Kosovës shfaqin tendencë të kundërta me ato të mësipërmet (Fig.12). Kështu vetëm 1% e të anketuarve konsiderojnë secilin prej institucioneve të sipërpërmendura të sigurisë të Kosovës si rrezik për Shqipërinë dhe rreth 2-4% i konsiderojnë këto institucione si “jo miqësore”. Nga ana tjetër rreth 77-80% e të intervistuarve i konsiderojnë ato si “miqësore” apo edhe “aleate” me një rënie në 66% përsa i përket shërbimit informativ. Sërish rreth 18% e të intervistuarve janë neutral përsa i përket policisë dhe ushtrisë kundërshtojnë 29% që janë neutral për shërbimin informativ.

Figura 12: Institucionet kosovare të sigurisë




Në këtë sondazh u konsiderua e një rëndësie të madhe matja e perceptimit të publikut në lidhje me fushat që mund të kontribuojnë më shumë në marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ndërmjet Shqipërisë, Serbisë dhe Kosovës. Për të pasur një menaxhim më të mirë të procesit, tetë fusha kryesore (të konsideruara si fushat më me ndikim në këtë aspekt) u ofruan si mundësi. Këto përfshinin: kontaktet ndërmjet njerëzve; tregtinë dhe ekonominë; infrastrukturën rrugore; bashkëpunimin policor/për sigurinë; shkëmbimet kulturore; luftën e përbashkët ndaj kriminalitetit; menaxhimin e emergjencave dhe së fundi, paraqitjen e përbashkët në nisma ndërkombëtare, diplomatike.

Lidhur me Serbinë (Fig.13) është interesante që fusha e sigurisë konsidero-

het si më e rëndësishmja në kuadrin e përmirësimit të marrëdhënieve me Shqipërinë. Pra kategorizimi si “shumë i mirë” dhe “i mirë” u shpreh për bashkëpunimin ndërmjet policisë/forcave të sigurisë dhe për “luftën e përbashkët ndaj krimit” prej përkatësisht 84% dhe 79% të të anketuarve shqiptarë. Nga ana tjetër fusha të tjera kanë marrë më pak vlerësim, 72% mbështetën “infrastrukturën rrugore” dhe vetëm 57% mbështetën opsionin “paraqitje e përbashkët në nisma ndërkombëtare”. Ajo që bën dallim nga fushat që nuk lidhen me sigurinë janë “shkëmbimet ekonomike dhe tregtare” të cilat u vlerësuan prej 87% të të anketuarve.

Figura 13: Përparësitë e bashkëpunimit (Serbia)




Në këtë kontekst, në lidhje me Kosovën (Fig.14), të anketuarit shqiptarë shfaqin thuajse të njëjtën mënyrë renditjeje për të tetë fushat e bashkëpunimit dhe për ndikimin që ato kanë për përmirësimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit, por vlerësimi për këto fusha rritet dukshëm. Kështu, “shkëmbimet ekonomike dhe tregtare” konsiderohen si një mënyrë “shumë e mirë” apo “e mirë” për përmirësimin e marrëdhënieve nga 94% e të anketuarve. Siguria mbetet e vlerësuar lart me thuajse 92%, ndërkohë që fusha të tjera u renditën më poshtë duke renditur si opsionin e fundit “paraqitje e përbashkët në nisma ndërkombëtare” (74%).

Në lidhje me Kosovën, numri i të anketuarve të cilët i konsiderojnë këto fusha si “inegzistente” është rreth 1% për “sigurinë” dhe “ekonominë” ndërkohë që ngrihet në 5-7% për fusha të tjera (kultura, bashkëpunimi për emergjencat dhe

përfaqësitë diplomatike të përbashkëta”). Në lidhje me Serbinë kjo kategori të intervistuarish është disi më e lartë me fushën e fundit “marrëdhënie të përbashkëta diplomatike” e cila ka një diferencë të dukshme dhe përmendet vetëm nga 14% e të anketuarve

Figura 14: Përparësitë e bashkëpunimit (Kosova)



Një pyetje specifike u përqendrua tek niveli i bashkëpunimit që Shqipëria ka vendosur tashmë veçanërisht me Serbinë dhe Kosovën dhe tek domosdoshmëria për ta përmirësuar këtë bashkëpunim (Fig.15). Lidhur me këtë, 48% e të anketuarve shqiptarë mendojnë se bashkëpunimi me Serbinë “nuk është i mirë dhe duhet ri-ndërtuar” ndërkohë që përsa i përket Kosovës kjo kategori të intervistuarish është vetëm 11%. Nga ana tjetër, kategoria e të intervistuarve që mendojnë se bashkëpunimi është “i mirë por ka nevojë të përmirësohet më tej” është 32%, përsa i përket Serbisë dhe 67%, për sa i përket Kosovës. Ky bashkëpunim konsiderohet si “i shkëlqyer” dhe që “nuk ka nevojë të përmirësohet” nga 15% e të intervistuarve, lidhur me Kosovën ndërsa vetëm 2% e tyre kanë këtë opinion përsa i përket Serbisë. Duke konsideruar faktin se këto tre kategori të intervistuarish të marra së bashku përbëjnë një qasje pozitive lidhur me këtë bashkëpunim duhet theksuar se në përgjithësi rreth 93% e të intervistuarve ndajnë opinion pozitiv lidhur me bashkëpunimin me Kosovën ndërkohë që në rastin e Serbisë kjo kategori të intervistuarish bie në 82%. Grupi i të anketuarve që mendojnë se bashkëpunimi “nuk është i mirë dhe se nuk ka nevojë për të bashkëpunuar” është

relativisht i vogël por megjithatë arrin deri në 4% për Kosovën dhe më shumë se dyfish (9%) për Serbinë..

Figura 15a: Cila nga pohimet është i drejtë në lidhje me bashkëpunimin me Serbinë?






Figura 15b: Cila nga pohimet është i drejtë në lidhje me bashkëpunimin me Kosovën?



Opinionin publik në Shqipëri shoh shumë pozitivisht çdo lloj mënyre për bashkëpunim rajonal në fushën e sigurisë ndërmjet Shqipërisë, Serbisë dhe Kosovës (Fig.16). Njëra nga pyetjet për të matur këtë opinion lidhej me “pjesëmarrjen e përbashkët në trajnimet e sigurisë rajonale”. Lidhur me këtë çështje, rreth 74% e të intervistuarve ishin pozitivë dhe prej tyre 34% “janë tërësisht dakord” ndërkohë që 40% e tyre janë “dakord”.

Një grup prej 21% “nuk janë kundër por as nuk pohojnë”. Kundërshtarët e kësaj mënyre bashkëpunimi përbëjnë vetëm 4% të të intervistuarve.

Figura 16: Shqipëria, Kosova, Serbia, pjesë e trajnimeve rajonale për sigurinë?



Përgjithësisht, sondazhi që u zhvillua nga IDM në Tetor 2013 në Shqipëri në fushën e sigurisë personale, sigurisë kombëtare dhe të bashkëpunimit rajonal për sigurinë midis Shqipërisë, Kosovës e Serbisë, për shkak të nivelit të lartë të përfaqësimit, si dhe numrit të madh të pyetjeve të përfshira ka mundësuar një sasi të madhe dhe të vlefshme informacioni, sidomos duke i projektuar gjetjet e këtij pyetësori në një kontekst rajonal. Produktet e tij mund të shërbejë gjithashtu si një burim mjaft i dobishëm informacionin dhe si referencë për institutet e tjerë kërkimorë në fushën e sigurisë. Gjithashtu këto gjetje mund të ndihmojnë në mbështetjen dhe reflektimin e disa prej pozicioneve zyrtarë të institucioneve tona shtetërore, sidomos po të mbahet parasysh që ato, jo rrallë, nga mosnjohja, ose për shkak të konjunkturave politike ndërkombëtare, nuk e marrin sa duhet në konsideratë opinionin e qytetarëve të vet.